



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, dhe me qëllim të evitimit të keqkuptimeve dhe tollovisë në Qendrën e Numërimi dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me date 01.11.2019, merr këtë:

VENDIM

për vazhdim të afatit të vlefshmërisë për distinktivët e vëzhguesve të akredituar që të mund të vazhdojnë të vëzhgojnë punën e Qendrës për Numërim dhe Rezultate - QNR

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të distinktivëve të vëzhguesve të akredituar të cilët mund të vëzhgojnë punën në Qendrën për Numërim dhe Rezultate – QNR deri në certifikim të rezultateve të Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar t'i njoftojë subjektet politike që kanë akredituar vëzhgues për këtë vendim të KQZ-së.
- III. Qendra për Numërim dhe Rezultate do t'u lejoj qasje të plotë për të vëzhguar aktivitetet e QNR-së vëzhguesve që posedojnë distinktiv edhe pse data e vlefshmërisë në distinktiv është e tejkaluar.
- IV. Numri i vëzhguesve nga një subjekt politik që mund të vëzhgojnë në të njëjtën kohë në QNR rregullohet sipas rregullave të KQZ-së dhe procedurave të QNR-së.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA

Valdete Daka, Kryetare